



VENDIM

Nr.43 Datë 07.04.2015

PËR

FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË
“PHOENIX PETROLEUM” SH.A. NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9946, date 30.06.2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, neni 14, pika 1, germa “ç”, si dhe neni 4, pika 1, germa “ç”; neni 8, neni 9 pika 1, germa “a”, “b”, “c”, “d”; pika 2, germa “a” dhe nenin 10, të “Rregullave dhe Procedurave për Liçensimin, Ndryshimin, Transferimin e Pjesëbëm ose të Plotë, Heqjen dhe Rinovimin e Liçensave në sektorin e Gazit Natyror”. miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 09, date 11.02. 2011, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.04.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “**PHOENIX PETROLEUM**” sh.a, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “**PHOENIX PETROLEUM**” sh.a, për liçensimin në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror të kësaj shoqërie plotëson pjesërisht kërkesat e ligjit si më poshtë vijon:

Neni 9, pika 1, gërma a
Tipi i aplikimit, është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 1, gërma b është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 1, gërma c është plotësuar në mënyrë korrekte.

Dokumentacioni ligjor, administrator dhe pronësor është i plotësuar pjesërisht,

Dokumentacioni dhe Garancitë Finaciare dhe Fiskale, plotësuar pjesërisht,

Të dhënat specifike sipas tipit të licensës plotësuar pjesërisht,

Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të neni 10, të “Rregullat dhe Procedurat për Liçensimin, Ndryshimin, Transferimin e Pjesëhem ose të Plotë, Heqjen dhe Rinovimin e Liçensave në sektorin e Gazit Natyror”, miratuar me Vendimin Nr. 9 datë 11/02/2011 të ERE , t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për liçensimin e shoqërisë **“Phoenix Petroleum”** sh.a., në aktivitetin e Tregëtimit të Gazit Natyror me shumicë.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI i ERE-s

Petrit AHMETI